



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 121/1 dt.22.09.1995

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi shqyrtoi relacionet e paraqitura nga Drejtoria e Shërbimeve Publike “Mbi kthimin në fond banese dhe pajisje me autorizim”, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.530, dt.17.10.1994, të ligjit Nr.7572, dt.10.05.1992, neni.14, pika.14 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.49, dt.29.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët” si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.43, dt.09.05.1995.

**VENDOSI**

1. Objekti ish magazinë e ndërmarrjes së Dekor – Funeralit që ndodhet në qytetin e nxënësve Rr.”Sabaudin Gabrani” në të cilën banojnë 12 familje ish të persekutuar politik të kaloj në fond banese. Pajisja e këtyre familjeve me autorizim për këto ambjente do të bëhet vetëm pasi Seksioni i Strehimit të paraqesë materialin përkatës (të kompletuar me statusin e të pastrehut) për shqyrtim në Këshillin Bashkiak.
2. Objekti ish trup roje në hyrje të K.S.”Partizani” që ndodhet në Rr.”Frosina Plaku” meqënëse është objekt i

Ministrisë së Mbrojtjes i takon asaj ta miratojë për kalim në fond banese.

3. Objekti i Uzinës Mekanike në Rr.e “Kavajës” që ndodhet në periferi të territorit të fonderisë së kësaj uzine të kthehet në fond banese i përkohshëm për strehimin e qytetarit Tasim Sula.
4. Objekti ish depo e Ndërmarrjes së Konservave Prodhim Makarona që ndodhet pranë kësaj ndërmarrje ti jepet me autorizim për strehim provizor qytetarit Sabri Xhaja.
5. Të pajisi me autorizim për objektin që ndodhet në Rr.”Hamdi Cenojmeri”, Pall.111 qytetarët e mëposhtëm :
  - Bedri Lala – shk.1, ap.13, 1+1
  - Robert Kosta – shk.1, ap.44, 1+1
  - Andrea Kola – shk.1, ap.15, 1+1
  - Dhimitër Kosta – shk.2, ap.17, 1+1
  - Teki Derraj – shk.2, ap.18, 1+1
6. Të anulohet autorizimi i dhënë me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.91, dt.01.08.1995, pika.1 për Z.Florjan Celiku për ap.1+1, shk.2, kati I në Rr.”Gjik Kuqali”, ish magazinë e NTPN.
  - Ky apartament ti kalojë Z.Tomor Dosti i cili dorëzon apartamenti e tij 3+1, që ndodhet në Rr.”4 Dëshmorët”, Pall.199, shk.2, ap.28.
  - Të pajisi me autorizim qytetarin Islam Lame, për ap.3+1 që ndodhet në Rr.”4 Dëshmorët”, Pall.199, shk.2, ap.28. Ky qytetar dorëzon apartamentin e tij që ndodhet në Rr.”Luigj Gurakuqi”, Pall.15/1, shk.2, ap.15/1.

- Të pajisi me autorizim qytetaren Nadire Elezi për apartamentin që ndodhet në Rr.”Luigj Gurakuqi”, Pall.15/1, shk.2, ap.15, 1+1, e cila dorëzon ap.2+1, që ndodhet në Rr.”Fabrika e Qelqit” që lihet në dispozicion të Bashkisë së Tiranës.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

8. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Seksioni i Strehimit.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**